

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ D.Dedej “ shpk**

Në Tiranë, sot më datë 20.06.2024, i poshtëshënuari:

- 1- Denis Dedej, i datëlindjes 08.11.1975, lindur në Lekaj dhe banues në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I40408059K,

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**D.Dedej “ shpk**,

Neni 1  
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin ‘**D.Dedej**’, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: Spille qendër, Nr.pasurie 4/7 , Kryevidh,

Neni 4  
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Veprimtari në fushën e hoteleri, turizem, bar -restorant dhe të tjera veprimtari të bazuar në ligjin shqiptar.



Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 1.000 Leke, i ndarë në një kuote, i cili zotërohet si më poshtë:

Denis Dedej, zotëron 1 kuotë me vlerë 1.000 Leke ( një mijë leke ), e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9  
Administrimi

Administratorë i shoqërisë është:

- 1- Denis Dedej, i datëlindjes 08.11.1975, lindur në Lekaj dhe banues në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I40408059K, , emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërritje.

Neni 10  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.



Neni 11  
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare “**D.Dedej** “ *shpk* , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES**

20/06/2024

Denis Dedej  
